

ALFRED ZYLFI



Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Performancës ne KLSH. Lindur ne vitin 1964. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(1987). 26 vite eksperience pune. 15 vitet e fundit si auditues në KLSH. Nga viti 2013 Auditues i Lartë
Fusha e ekspertizes: Auditimi i të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

PSE AUDITIMET E PERFORMANCES JANE PERPARESI NE KLSHⁱ

nga Alfred Zylfi

Në më shumë se një vit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ndërmarrë një nismë të re në përmirësimin metodave të auditimit të politikave qeverisëse dhe të njësive ekonomike publike. Kjo iniciativë e ndërmarrë duhet përgëzuar pasi auditimi i performancës i cili është në hapat e para në mënyrën e kryerjes së auditimeve, kjo dhe për faktin e thjeshtë se ai pothuajse nuk është zbatuar më parë në historinë e auditimit në Shqipëri. Kryerja e këtyre auditimeve dhe ritja e numrit të tyre në fushat për të cilat ka ndjeshmëri më të madhe publike sjell zhvillim pasi ndihmon administratën publike qendrore dhe njësitë ekonomike publike më të vogla në realizimin e objektivave në mënyrë sa më ekonomike, eficiente dhe efektive (3E).

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kryerjen e këtij auditimi mbështetet përveç të tjerash edhe në udhëzuesin e auditimit të performancës ISSAI 3000-3100 i cili është dhe udhërrëfyesi mbi mënyrën e kryerjes së auditimit të performancës. Në parathënien e tij është shprehur në pak fjalë qëllimi i kryerjes së auditimit të performancës e konkretisht;”...*auditimi i performancës synon korrektimet e duhura, aplikimin e teknikave më të fundit*

shkencore, përmirësimin e 3 E-ve dhe tek e fundit rritjen e mirëqënies sociale përmes aktivitetit ekonomik publik...Gjithshka ka të bëjë me një emërues të përbashkët: rritjen e ndërgjegjësimit të strukturave vendim – marrëse, me synim përmirësimin e bërjes së gjërave, në mënyrë shkencore dhe bashkëkohore(parathënia nga Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit).

Auditimi i performancës në vetëvete pra është një shqyrtim i pavaruar i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve organizatave publike, duke iu përmbajtur ekonomicitetit. Ndërkohë që auditimet e tjera priren të aplikojë standarde relativisht të ngurta, auditimi i performancës është më gjithëpërfshirës dhe nuk bazohet vetëm në vlera numerike, por edhe nëse institucionet publike kanë realizuar objektivat e tyre. Qëllimi i këtij auditimi është nxjerrja në pah e anëve pozitive dhe identifikimi i përmirësimit të metodave të punës të njësive ekonomike dhe institucioneve publike.

Auditimi i performancës ka vështirësi, ku më kryesorja është misioni i tij i dyfishtë i cili nganjëherë interpretohet si kontradiktore që mbart: fajësimim kundrejt këshillimit; përmirësim procesi apo dhe përmirësim e sistemit të institucioneve. Auditimi i performancës i prek dhe i përcakton dështimet e shpërdorim të burimeve publike, por nga ana tjetër, zhvillon strategji për të bërë veprimtaritë e qeverisjes sa më efçente dhe efektive.

Një nga vështirësitë që audituesit përballen është përcaktimi i saktë kritereve me të cilën do vlerësohen institucionet publike. Një tjetër vështirësi ka të bëjë me vlerësimin e situatës aktuale të institucioneve duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë.

Megjithatë auditime të tilla ndihmojnë drejtuesit dhe personelin që të theksojnë rëndësinë e matjes së ekonomicitetit, efçencës, efektivitetit;

këshillojnë mënyra të reja për përmirësimin e proceseve të punës dhe veprimtaritë ku efienca është e vështirë për t'u matur; ndihmojnë në rritjen e sasisë ose përmirësimin e cilësisë të outputeve dhe nivelit të shërbimeve pa rritur shpenzimet; sjellin ndryshimet si dhe ndihmojnë njësitë ekonomike publike në përdorimin sa më të mirë të burimeve të tyre. Një tregues tjetër që duhet të merret në konsideratë në këto llojë auditimesh është se auditimet e performancës janë më të kuptueshme, ndryshe nga auditimet financiare dhe ato të ligjshmërisë të cilat kanë një terminologji teknike ndonëse dhe të vështirë për t'u kuptuar nga palët e treta publike i gjërë i cili nuk është i kualifikuar në çdo problematikë të trajtuar.

Deri tani auditimi i performancës është parë si i dobishëm jo vetëm nga KLSH por edhe nga institucionet e audituara. Megjithëse KLSH ka rreth një vit që ka krijuar departamentin e performancës e janë kryer shumë pak auditime për të dhënë një panoramë të qartë e të drejtë të ecurisë së subjekteve të audituara, mund të themi se raportet e deritanishme kanë patur impakt pozitiv dhe një frymë mirëkuptimi për problematikën e trajtuar dhe zbatimin të rekomandimeve në to. Marrja në konsideratë, trajtimi i problematikave dhe rekomandimeve, është një tregues i mirë që në të ardhmen do të sjellë përfitimet dhe zhvillime të mëtejshme në hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve sa më të drejta nga institucionet publike. Përmirësimi i sistemeve dhe politikave të institucioneve publike do të sjellë vendimmarrje që fokusohen më tepër në ekonomikitetin, efiençën dhe efektivitetin e proceseve të punëve.

Për të rritur më tej përgjegjësinë në këtë auditim, Departamenti i Auditimit të Performancës ka hapur dhe faqen e tij jo zyrtare në Facebook, ku mirëpret çdo mendim sygjërim dhe debat për temat e audituara, të planifikuara opo dhe mendime për auditime të reja në që mund te kryhen në këtë fusha të ndryshme.

Pavarësisht vështirësive të metodave të reja që KLSH po ndërmerr me këtë lloj të ri auditimi, mund të themi se ai po ecën përkrah institucioneve homologe dhe është duke u bërë promotor në përmirësimin e proceseve e politikave të institucioneve publike.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 11 Dhjetor 2013